

DEKRET

Nr. 782, date 22.02.1994

PER SISTEMIN FISKAL NE SEKTORIN E HIDROKARBUREVE (KERKIM - PRODHIMI)

Ne mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit Nr. 7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Keshillit të Ministrave

D e k r e t o j,

Neni 1

Kontraktuesi detyrohet të paguajë çdo vit fiskal vetëm tatimin mbi fitimin e realizuar në atë vit fiskal. Fitimi i realizuar mund të shprehet në natyrë a në para ose në formë të perziera, sic mund të parashikohet në çdo marrëveshje hidrokarburesh.

Tatimi mbi fitimin është :

1. Në masën 50 për qind të fitimit të realizuar.
2. Në rast se kontraktuesi, në përputhje me nenin 12, pika 2, të ligjit "Për hidrokarburet" është Albpetroli dhe ky zoteron nga 50 për qind deri në 100 për qind të interesave në marrëveshje hidrokarburesh, tatimi është :
 - a) 30 përqind të fitimit të realizuar nga objektet e zbuluara dhe të vena në shfrytëzim përpara datës 31.12.1993
 - b) Për fitimin e realizuar nga zona të tjera (të vena në shfrytëzim pas datës 31.12.1993) tatimi mbi fitimin është :
 - 30 për qind për sasi hidrokarburesh të prodhuara deri në 20.000 barela në ditë.
 - 50 për qind për çdo sasi hidrokarburesh shtese të prodhuara nga 20.000 deri në 50.000 barela në ditë
 - 55 për qind për çdo sasi hidrokarburesh shtese të prodhuara nga 50.000 deri në 65.000 barela në ditë
 - 60 për qind për çdo sasi hidrokarburesh shtese të prodhuara mbi 65.000 barela në ditë
3. Për shfrytëzimin e vendburimeve marginale të zbuluara ose të kthyera në marginale nga shfrytëzimi i tyre, Keshilli i Ministrave mund të nxjerrë vendime të posaçme për

lehtesimin e sistemit fiskal me qellimin e vetem qe keto lloj vendburimesh te kthehen ne ekonomikisht te shfrytezueshme.

Neni 2

Per efekt te llogaritjes se fitimit te realizuar, kontraktuesit i njihen si kosto shpenzimet kapitale, ato operative e administrative etj. (specifikimet perkatese behen ne cdo marreveshje hidrokarburesh e miratohen nga ministri) dhe lejohet shlyerja e tyre nga te ardhurat e fituara sipas kriterëve te pranuar nga ministri, si dhe sipas praktikave nderkombetare te industrise se naftes qe zbatohen ne cdo marreveshje hidrokarburesh.

Neni 3

Kontraktuesi dhe nenkontraktuesit e tij perjashtohen nga detyrimet doganore per paisjet, makinerite, materialet, etj.

Gjithashtu, trajtohen njelloj si ne paragrafin e mesiperme te ketij neni edhe mjetet e jeteses se punonjesve te huaj te kontraktuesit e nenkontraktuesve te tij, qe lidhen me operacionet e naftes, ne rast se nuk vendoset ndryshe nga Keshilli i Ministrave.

Neni 4

Punonjesit e huaj te kontraktuesit dhe nenkontraktuesve te tij perjashtohen nga tatimi mbi te ardhurat personale qe sigurohen nga operacionet e naftes.

Neni 5

Ky dekret hyn ne fuqi menjehere.

KUNDERFIRMOHET

KRYEMINISTRI

Aleksander MEKSI

PRESIDENTI I REPUBLIKES

Sali BERISHA

